

*Buletini i
Këshillit të
Ankesave*



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Nr.5

QERSHOR 2019

Buletini i Këshillit të Ankesave
Nr.5

Shtëpia Botuese “Ani Print”
©Autoriteti i Mediave Audiovizive

Tiranë, 2019

Përmbajtja

Hyrja	7
SEKSIONI I	
Ankesa me subjekt “cenim i rregullave të etikës dhe dinjitetit”	9
SEKSIONI II	
Ankesa me subjekt “cenim i të drejtave të fëmijëve”	17
SEKSIONI III	
Ankesa me subjekt "komunikime tregtare të ndaluara"	25
SEKSIONI IV	
Ankesa të tjera	31
SEKSIONI V	
Ankesa të rrëzuara	39

Hyrje

Më pak se dy vjet që nga krijimi i Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), përgjatë vitit 2018 u përmyll i gjithë kuadri nënligjor i kërkuar nga ligji nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, që lidhet pikërisht me punën dhe detyrat e Këshillit të Ankesave.

Pas miratimit, në fund të vitit 2017, të rregullores “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”, në maj 2018 u miratua edhe udhëzimi “*Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)*”.

Miratimi i udhëzimit erdhi gjithashtu në vijim të përmbushjes së detyrave të parashikuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2017*”. Në pikën 10 të kësaj Rezolute, Kuvendi nxit dhe kërkon nga Autoriteti i Mediave Audiovizive “*rritjen e efikasitetit në shqyrtimin e ankesave e ardhura nga qytetarët dhe institucionet për shkelje të parimeve të mbrojtjes së interesit publik, respektimit të dinjitetit të individëve dhe rregullave që parashikohen në Kodin e Transmetimit, shtimin e organizimit të tryezave tematike,*

si dhe të dëgjësive me grupe të ndryshme interesi për njohjen me përmbajtjen e Kodit të Transmetimit dhe ndërgjegjësimin e respektimit të tij”.

Më hyrjen në fuqi të udhëzimit, Këshilli i Ankesave u ka kërkuar zyrtarisht të gjithë OSHMA-ve ngritjen e Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave. Në të njëjtën kohë, po ndjek nga afër procesin e ngritjes së tyre. Aktualisht, televizionit kombëtare dhe disa rajonale kanë ngritur Bordet e Shqyrtimit të Ankesave dhe Këshilli i Ankesave i ka inkurajuar ato të bëhen pjesë aktive e shqyrtimit të ankesave.

Përmyllja e këtyre akteve dhe ndjekja e tyre është një hap më tej në këtë rrugë të gjatë e plotë sfida, por nga ana tjetër, ka përmirësuar, nga pikëpamja procedurale dhe profesionale, trajtimin e ankesave. Përfshirja e OSHMA-ve e ka ndihmuar gjithë procesin e shqyrtimit të ankesave dhe ka ndihmuar gjithashtu edhe për sensibilizimin mbi zbatimin e normave dhe kërkesave ligjore/etike.

*Ankesa me
subjekt
"cenim
i rregullave
te etikës
dhe dinjitetit"*

Ankesa e paraqitur nga: **A.A.**

Subjekti audioviziv:

“Ora News”

Programi:

Emisioni “Boom”

Data:

13.04.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi A.A. pretendonte se emisioni investigativ-satirik “Boom” ka transmetuar dy kronika të njëanshme, duke i prekur të drejtën e tij të privatësisë. Sipas ankuesit, në dy emisione të “Boom”, “i është shkelur e drejta e prezumimit të pafajësisë, ndërkohë që gjykata nuk ka dhënë ende një vendim”.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave Vendimi i Bordit të AMA-s

Pas marrjes së kësaj ankesë, Këshilli i Ankesave filloi shqyrtimin e saj dhe i kërkoi zyrtarisht subjektit audioviziv paraqitjen e pretendimeve ndaj ankesës së z. Avduli. Pas shqyrtimit të materialeve filmike dhe marrjes së pretendimeve nga stafi i emisionit në fjalë, Këshilli i Ankesave çmoi se, emisioni “Boom” ka trajtuar një ngjarje me interes publik. Nisur nga pretendimi i ankuesit për shkeljen e privatësisë, Këshilli i Ankesave gjykoi se, në këtë rast ka përparësi interesi publik. Si përfundim, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit.

Kundër këtij konkluzioni, shtetasi A.A. u ankua në Bordin e Autoritetit

të Medias Audiovizive (AMA). Bordi, i mbledhur më datë 06.02.2019, mori në shqyrtim pretendimet e shtetasit A.A. ndaj konkluzioneve të Këshillit të Ankesave lidhur me ankesën e tij ndaj emisionit investigativ-satirik “Boom”.

Mbi pretendimin e shtetasit A.A., Këshilli i Ankesave i paraqiti Bordit të AMA-s një relacion shterues për rastin në fjalë.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, Bordi i AMA-s vlerësoi se, kemi të bëjmë me transmetimin e një materiali në interes të publikut, por transmetimi nuk ka respektuar plotësisht normat e Kodit të Transmetimit. Bordi i AMA-s vlerësoi se trajtimi i çdo çështjeje, pavarësisht interesit publik që paraqet, duhet të respektojë në maksimum privatësinë e çdo shtetasi që mund të preket nga një transmetim audioviziv. Në rastin konkret, Bordi i AMA-s e konsideroi të nevojshme që transmetimi duhet të kishte ruajtjet privatësinë e shtetasit A.A., si person jo publik, dhe që transmetimi mund t’a përfshinte vetëm përmes inicialeve.

Për sa më sipër, Bordi i AMA-s vendosi t’i tërheqë vëmendjen televizionit “Ora News”, duke rikujtuar respektimin e Kodit të Transmetimit për ruajtjen e privatësisë së çdo pale të prekur në transmetimet e ardhshme audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **Urdhri i Psikologut**

Subjekti audioviziv:

“News 24”

Programi:

“Me zemër të hapur”

Data:

26.07.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Urdhri i Psikologut u ankua se, gjatë një lidhje të drejtpërdrejtë në emisionin “Me zemër të hapur”, që transmetohet në televizionin “News 24”, i është kërkuar një psikologeje të shprehet në lidhje me një çështje gjyqësore ku ajo ka qenë e pranishme. Sipas ankesës, pavarësisht insistimit të gazetares, psikologia nuk ka dhënë informacion. Urdhri i Psikologut pretendon se, dhënia e këtyre informacioneve bie në kundërshtim me parimet e Kodit Etik dhe Profesional të Psikologut dhe rasti në fjalë shkel edhe parimin e mbrojtjes së jetës private të një të mituri.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik të arkivuar dhe konstatoi se:

- gjatë bisedës në studio për çështjen në fjalë është ruajtur me korrektesë identiteti i të miturve, si dhe i nënës së tyre që ndodhej në studio;
- diskutimi i çështjes ka qenë brenda kornizave etike, profesionale dhe ligjore, duke u përpjekur të shmangen të dhëna të ndjeshme lidhur me të miturit dhe të mos cenohen të drejtat e tyre;

- në lidhjen telefonike me psikologun J.M., nga drejtuesja e emisionit nuk janë kërkuar të dhëna e detaje mbi identitetin e të miturve dhe as detaje të tjera që mund të cenojnë privatësinë apo të drejtat e tyre, por janë kërkuar në thelb konkluzionet e psikologes, të paraqitura në gjykatë. Meqë psikologia pohoi se ishte në lëvizje dhe se nuk mbante mend shumë të dhëna nga çështja që po diskutohej, pasi siç e tha dhe vetë, shqyrtonte shumë çështje të ngjashme përgjatë një muaji, iu kërkuar, dhe ajo vetë pranoi, që materialin e kërkuar t’a dërgonte në redaksinë e emisionit. Këtu është mbyllur biseda telefonike midis drejtueses së emisionit dhe psikologes, bisedë që në vlerësimin e Këshillit nuk ka pasur këmbëngulje jashtë normave etike apo në dëm të interesave të të miturve.

Bazuar sa më sipër, në konkluzionet e tij Këshilli i Ankesave nënvizoi se, gjatë emisionit nuk ka pasur cenim të parimeve, rregullave dhe kërkesave të Kodit të Transmetimit sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **M.L.**

Subjekti audioviziv:

“Channel One”

Programi:

“Dosja Investigative”

Data:

11.12.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi M.L. pretendonte se në emisionin “Dosja Investigative”, që transmetohet në televizionin “Channel One”, është përgojuar padrejtësisht, jashtë çdo norme etike dhe, për më tepër, ndaj tij është shpifur dhe fyer në lidhje me blerjen e një prone në Tiranë.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e ankesës duke i kërkuar subjektit audioviziv të paraqesë pretendimet e veta. Referuar nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “*Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes*”, si dhe udhëzimit “*Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatic Audioviziv*”, Këshilli i Ankesave i kërkoj Bordit të Shqyrtimit të Ankesave dhe televizionit “Channel One” paraqitjen e pretendimeve të tyre për këtë rast.

Nga pretendimet e paraqitura pranë AMA-s rezulton se, emisioni e ka filluar investigimin e temës në fjalë pas një denoncimi të ardhur nga

një qytetar. Redaksia e emisionit kontaktoi denoncuesin M. T., të cilit “i ishte marrë padrejtësisht një pronë”. Ndërkaq, stafi i emisionit, pasi administroi dokumentacionin për këtë çështje nga pala denoncuese, kërkoj reagimin e palës tjetër si blerës të kësaj prone, konkretisht shtetasve V.K. dhe M.L., por “nuk u gjet bashkëpunim, por vetëm shmangie dhe fyerje”.

Sipas Bordit të Shqyrtimit të Ankesave në “Channel One”, në asnjë rast nuk është përmendur funksioni (konsull) i një prej ankuesve.

Nisur nga ankesa dhe nga pretendimet e televizionit, Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e materialit filmik të transmetuar në emisionin “Dosja Investigative”. Pas shqyrtimit të materialit filmik dhe pretendimeve të të dy palëve, Këshilli i Ankesave paraqiti konkluzionet e tij: Nuk u konstatuan shkelje të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **A.D.**

Subjekti audioviziv:	Programi:	Data:
“Klan TV”	“Shihemi në gjyq”	26.06.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasja A. D. u ankua se, në rubrikën “Shihemi në gjyq” të emisionit “E diela Shqiptare”, që transmetohet në televizionin “Klan”, është shkëlur Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Konkretisht, ankuesja pretendon se, në rubrikën e datës 27 maj 2018, objekt diskutimi ishte një testament i vërtetuar nga ana e saj si notere. Sipas saj, testamenti është në fuqi dhe nuk është kundërshtuar nga palët në gjykatë. Ankuesja pretendon gjithashtu se, gjatë rubrikës, drejtuesja znj. Eni Çobani ka bërë akuza të rënda ndaj saj, duke e cilësuar “fajtores që ka kryer vepër penale”. Sipas ankueses A.D., “në kundërshtim me ligjin për mediat janë cenuar të drejtat e saj si qytetare, është dëmtuar puna dhe imazhi i saj, trajtimi i çështjes ka qenë i njëanshëm dhe është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë”.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi se, gjatë rubrikës, znj. Çobani ka identifikuar ankuesen me identitet të plotë. Më tej, znj. Çobani është shprehur gjatë emisionit se “testamenti është i vlefshëm nga ana formale” dhe se “gjykata ka pasur për detyrë të verifikojë nëse ka rezerva ligjore që ky testament të qëndrojë në fuqi”. Më herët kishte deklaruar se “ky

testament është një vepër penale, e kryer nga noterja në fjalë”.

vNisur nga këto qëndrime publike, Këshilli i Ankesave gjeti të drejtë pretendimin e znj. A.D.. Neni 33, pika b) e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detyron OSHMA-në (operatorin audioviziv) “*të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme*”.

Gjithashtu, ligji i sipërcituar dhe Kodi i Transmetimit kërkon respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Kodi i Transmetimit përligj shkëljen e këtij parimi vetëm në “*zbulimin apo ekspozimin e krimit apo të padrejtësisë serioze*”. Në rastin konkret, nëse mund të jemi para një rasti të tillë, drejtuesja e rubrikës ndaj së cilës u paraqit ankesa duhet të vepronte sipas ligjit, duke e denoncuar në autoritetet përkatëse. Por në çdo rast, publikimi mund të ndodhë vetëm në ngjarje të veçanta dhe kur ka interes publik.

Së fundmi, gjatë rubrikës u konstatua identifikimi i plotë i shtetases A.D., ç’ka ndalohet në Kodin e Transmetimit.

Në pikën 3.2 të tij thuhet se “*identifikimi i një biznesi apo një individi në mënyrë indirekte apo aksidentale në raportimin e një ngjarjeje me interes publik mund të publikohet, përveç rasteve kur vërtetohet se kjo mund të shkaktojë dëm direkt apo paragjykim ndaj tyre*”.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes**

Subjekti audioviziv:

Tv “Klan”

Programi:

Emisioni “Stop”

Data:

23.11.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pretendon se, gjatë transmetimit të emisionit “Stop”, që transmetohet në televizionin “Klan”, është trajtuar rasti i një ish-punonjëseje, duke publikuar të dhëna të ndjeshme, në shkellje të ligjit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit paraqitjen e pretendimeve mbi ankesën e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM). Këshilli i Ankesave vijoi me shqyrtimin e ankesës pa pasur mundësinë e shqyrtimit edhe të pretendimeve që duhet të ishin paraqitur nga operatori audioviziv.

Nga shqyrtimi i pamjeve filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi se, pavarësisht interesit publik të trajtimit të çështjes, ka ekspozim të tepruar të emrave dhe fotove të punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në kundërshtim me Ligjin nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”. Neni 25 i këtij ligji përcakton se: “Përjashtimi nga publikimi”, ndalon publikimin e

informacioneve që kanë të bëjnë me të dhëna të klasifikuara”. Pika 1 dhe 2 e këtij neni, shprehen përkatësisht: “Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ndalohet të japë informacion që ka të bëjë me të dhëna të klasifikuara dhe përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të të dhënave, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, si dhe të numrit të punonjësve të kësaj Agjencie”, si dhe “Autoritetet, subjektet dhe individët që njihen me informacione të përfuara nga veprimtaria e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, e kanë të ndaluar, për çdo lloj motivi, dhënien, keqpërdorimin apo bërjen publike të tyre”.

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit ndaj të cilit drejtohej ankesa ndalimin e publikimeve të mëtejshme që kanë të bëjnë me të dhëna të klasifikuara, si dhe fshirjen nga kanali i tij zyrtar në Youtube të publikimeve të tilla të deritanishme.

Ankesa e paraqitur nga: **E.K.**

Subjekti audioviziv:	Programi:	Data:
Tv "Klan"	Emisioni "Stop"	12.11.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja E.K. kërkonte fshirjen e një lajmi të publikuar në faqen zyrtare të internetit të televizionit "Klan". Lajmi i referohej një kronike të emisionit satiriko-investigativ "Stop", që transmetohet gjithashtu në televizionin "Klan". Ankuesja kërkonte edhe përgënjeshtimin e lajmit nga televizioni përkatës.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi pretendimet e ankueses E.K. dhe në konkluzionet e tij nënvizoi:

-Kërkesa për fshirjen e lajmit në faqen zyrtare të televizionit "Klan" nuk mund të trajtohet nga Këshilli i Ankesave. Kjo kërkesë është jashtë kuadrit ligjor mbi të cilin bazohet veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Si e tillë, kërkesa juaj është jashtë objektit të punës së Autoritetit, e për rrjedhojë, edhe jashtë objektit të punës së Këshillit të Ankesave pranë AMA-s.

-Në lidhje me kërkesën e një përgënjeshtrimi, ankuesja ose përfaqësuesja ligjore mund t'i drejtohen fillimisht televizionit

"Klan" për të drejtën e përgjigjes, bazuar në nenin 13, "Ushtrimi i të drejtës së përgjigjes" të Udhëzimit "Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes".

-Gjatë shqyrtimit të materialit përkatës filmik, të transmetuar nga emisionin "Stop", Këshilli i Ankesave konstatoi se, gjuha e përdorur gjatë emisionit ishte fyese ndaj shtetases E.K. Gjithashtu u konstatua reklamë e fshehtë për një subjekt tjetër, klinikë private, ç'ka u konsiderua komunikim tregtar i ndaluar nga ligji.

Sipas Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, OSHMA-ja ka detyrimin që gjatë transmetimeve të saj "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut" (neni 33, pika ç, "Detyrimet e OSHMA-ve").

Gjithashtu, pika 4 e nenit 19 të Rregullores "Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare, format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave", ndalon transmetimin e komunikimeve tregtare me natyrë të fshehtë: "Transmetimi i komunikimeve me natyrë tregtare të fshehtë ndalohet".

Nisur sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së dhe i kërkoi të mos e ritransmetojë emisionin "Stop", të datës 08.11.2018.

2

A Ankesa me
subjekt
"cenim i
të drejtave
të femijëve"

Ankesa e paraqitur nga: **Këshilli i Medias**

Subjekti audioviziv:

“Top Channel”

Programi:

“Fiks Fare”

Data:

25.09.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Medias ngriti shqetësimin mbi një kronikë dhënë në emisionin “Fiks Fare”, që transmetohet në televizionin “Top Channel”. Ankesa i referohej publikimit të historisë së një vajze të mitur, e cila nuk mund të frekuentonte shkollën për arsye të gjakmarrjes.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit. Gjatë intervistimit, vajzës së mitur iu publikua identiteti, emri i saj, mbiemri i gjyshërve ndërsa mbulimi i fytyrës ishte i pjesshëm, vetëm tek pjesa e syve.

Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, Seksioni 5, “Fëmijët në transmetimet audiovizive”, pika 5.1 detyron mediat audiovizive të shmangin çdo raportim që çon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve: *“OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë*

ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale”.

Pika, 5.2 e Kodit të Transmetimit sanksionon më tej se *“duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare”.*

Vajza e mitur është intervistuar pa marrë parasysh rregullat e sanksionuara në Kodin e Transmetimit. Pranë saj nuk ndodhej asnjë prej prindërve dhe, ndonëse vajza përjetoi një tronditje gjatë intervistës, ajo u transmetua e plotë, duke shkelur rëndë të drejtat e saj. Si rezultat i kësaj interviste, e mitura mund të ketë pasoja të rënda psikologjike në të ardhmen.

Bazuar në parimet e Kodit të Transmetimit, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen televizionit dhe i kërkoi heqjen e materialit video nga kanali i tij zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**

Subjekti audioviziv:

“Report TV”

Programi:

“Pa Gjurmë”

Data:

22.10.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës pretendon për shkëlqje gjatë intervistimit të një të miture, në emisionin “Pa gjurmë”, që transmetohet në “Report Tv”. Ankesa bazohej në publikimin e historisë së abuzimit seksual ndaj një vajze 17-vjeçare, abuzim i kryer kohë më parë, por i rikthyer në vëmendje gjatë transmetimit të emisionit “Pa gjurmë”. Sipas Agjencisë, intervista e vajzës së dhunuar, edhe pse e mbuluar, identifikon të miturën për shkak të intervistimit të nënës së saj, me identitet të plotë, me zë dhe figurë.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin video dhe konstatoi se, pretendimi i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është pjesërisht i drejtë.

Publikimi i historisë së vajzës së dhunuar përbën interes publik, por në transmetimin e palëve të treta, mundësohet identifikimi i vajzës, duke shkelur në këtë mënyrë parimet ligjore

dhe etike të Kodit të Transmetimit.

Këshilli i Ankesave konstatoi se, gjatë intervistës janë dhënë detaje të panevojshme për fshatin e së miturës, vendin ku ajo banon dhe për familjen e saj.

Seksioni 5 i këtij Kodi, “Fëmijët në transmetimet audiovizive”, pika 5.1 detyron mediat audiovizive të shmangin çdo raportim që çon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve: *“OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale”*.

Pika 5.2 e Kodit të Transmetimit sanksionon më tej se *“duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare”*.

Edhe pika 5.5 sanksionon qartësisht: *“Kujdes duhet treguar edhe me raportimin dhe transmetimin e palëve të treta, jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës...”*.

Këshilli i Ankesave risolli në vëmendje konsultimin e Kodit të Transmetimit në çdo rast kur pjesë e përmbajtjes janë fëmijët. Në rastin konkret, Kodi i Transmetimit është zbatuar në intervistën e të miturës duke e mbuluar por intervistimi i palëve të treta me zë dhe figurë, duke dhënë edhe detaje të tjera që çojnë në intetifikimin e vajzës, përbën shkelje të Kodit të Transmetimit. Në çdo intervistë të një fëmijë në kushte të cilësuar, viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, duhet të respektohet tërësisht anonimati i tij.

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen televizionit dhe e paralajmëroi për marrjen e sanksioneve sipas ligjit në rast përsëritjeje të shkeljes së ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**

Subjekti audioviziv:	Programi:	Data:
“Ora News”	Edicioni informativ	29.04.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Duke iu referuar një lajmi të transmetuar gjatë edicionit informativ të datës 29.04.2018, në televizionin “Ora News”, mbi arrestimin e një mësuesi në Delvinë të akuzuar për ngacmim seksual ndaj një nxënëseje, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pretendon se, përmendja e inicialeve dhe intervista e vajzës e sfumuar nuk kanë mjaftuar, pasi vajza është identifikuar. Kronika e lajmit përmbante detaje të panevojshme, si pamje nga fshati i nxënëses, nga shkolla dhe klasa e saj, nga banesa, si dhe pati intervista me të afërm të saj, xhaxhai dhe gjyshja. Të gjitha këto detaje e identifikojnë lehtësisht viktimën.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi pretendimet e Agjencisë. Vajza është përmendur vetëm me iniciale gjatë kronikës, ndërsa gjatë intervistimit janë marrë masa për të mos i ekspozuar fytyrën e saj. Megjithatë ajo është identifikuar në mënyrë të tërthortë, për shkak të detajeve të shumta që u transmetuan: pamjeve nga fshati i saj, klasa dhe

shkolla e saj, por më së shumti edhe nga intervista me xhaxhain dhe gjyshen e vajzës.

Pika 5.1 e Kodit të Transmetimit përcakton se *“OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me generalitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale”*.

Kodi i Transmetimit për median audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 11.12.2017, i detyron OSHMA-të që, të tregojnë kujdes maksimal për mbrojtjen e identitetit të fëmijëve. Në këto kushte, Këshilli i Ankesave sugjeroi tërheqje vëmendje dhe kërkoi që në raste të tilla të tregohet kujdes për respektimin e të dhënave dhe identitetit të fëmijës.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**

Subjekti audioviziv:

Report TV

Programi:

"Pa gjurmë"

Data:

14.11.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Sipas Agjencisë, emisioni “Pa gjurmë ka publikuar historinë e një 10-vjeçari të birësuar, duke shkelur normat ligjore.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik të emisionit në fjalë dhe konstatoi shkelje të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit të AMA-s.

Gjatë emisionit është intervistuar nëna e të miturit të birësuar, të cilës i janë publikuar identitetet e plota (emër dhe mbiemër), ndërsa është publikuar edhe emri i fëmijës. Këshilli i Ankesave çmon se, televizioni ka mënyra të tjera për të ndjekur historinë e birësimit të të miturit, por duke respektuar në çdo rast normat etike dhe ligjore, dhe në veçanti, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të privatësisë së tyre. Në rastin e emisionit në fjalë, identifikimi i plotë i nënës së 10-vjeçarit dhe publikimi i emrit të të miturit mundësojnë plotësisht identifikimin e këtij të fundit.

Në nenin 33 të Ligjit 97/2013, për detyrimet e OSHMA-ve, në pikën dh) sanksionohet se “OSHMA-të duhet të

mos cenojnë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe”.

Ndërsa pika 5.1 e Kodit të Transmetimit të AMA-s, i detyron që mediat audiovizive të shmangin çdo raportim që çon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në identifikimin e fëmijëve: *“OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale”.*

Më tej, pika 5.2 e këtij Kodi sanksionon qartësisht se *“duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare”.*

Subjektit iu bë e ditur se është nën monitorim të vazhdueshëm dhe se kjo është masa e fundit “Tërheqje vëmendje” ndaj tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes së Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit, AMA do të fillojë procedimin sipas kërkesave të parashikuara ligjore.

3



A nkesa për
komunikimin
tregtar të ndaluar

Ankesa e paraqitur: **Kryesisht nga Këshilli i Ankesave**

Subjekti audioviziv:

Top Channel

Programi:

“Ftesë në 5”

Data:

17.05.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, bazuar në Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u konstatua se në emisionin “Ftesë në 5” dhe “Në shtëpinë tonë” nuk janë respektuar kërkesat për reklamat dhe komunikimet tregtare.

Transmetimi i këtyre përmbajtjeve është në kundërshtim me nenin 42, pika 1 e ligjit ku përcaktohet se *“Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara”*.

Për sa më sipër, AMA ju tërhoqi vëmendjen për ndërprerjen e menjëhershme të praktikave të tilla gjatë transmetimit. Përsëritja e tyre do të shoqërohet me fillimin e procedimit, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Konkretisht, më 11.12.2018 nga ora 17.27 deri në 17.41, gjatë emisionit “Ftesë në 5” u transmetua një kronikë ku reklamohen produktet e AVON. Në studio ishin 4 përfaqësues të kësaj kompanie, të cilët reklamuan cilësitë, shumëllojshmëritë dhe ofertat për festat e fundvitit, shoqëruar edhe me insert audioviziv.

Në 14.12.2018, nga ora 09.33 deri në 09.54, gjatë emisionit “Në shtëpinë tonë” u transmetua një kronikë ku u reklamuan produktet e KENWOOD. Drejtuesit e programit reklamuan cilësitë dhe ofertat për produktet duke i demonstruar në studion e programit.

Ankesa e paraqitur nga: **A. K.**

Subjekti audioviziv:	Programi:	Data:
“Top Channel” “Klan Tv”	“Në shtëpinë tonë” “Në kurthin e Piter Panit”	17.05.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Ankesa nga shtetasja A.K. ngre shqetësimin e promovimit të ushqimit të bebeve në dy programet televizive. Sipas pretendimit të saj, ligji nr.8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjii” nuk lejon asnjë lloj reklame për ushqimet e bebeve nga 0-3 vjeç.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi se reklama mbi ushqimin e fëmijëve, konkretisht në emisionet “Në kurthin e Piter Pan”, në TV Klan dhe “Në shtëpinë tonë”, në Top Channel, distribuohet nga kompania “España Pharm”.

Duke qenë se Ligji nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjii”, i ndryshuar, rregullon tregtimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit për të ushqyerit e fëmijëve, AMA me shkresën nr. 2335 prot. datë 23.05.2018, i kërkoi Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) shqyrtimin e përputhshmërisë ligjore të reklamave në fjalë.

ISHSH, në përgjigjen e tij, të dërguar në AMA me shkresën nr. 796/2 prot., nënvizon se: Ligji nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjii”, i ndryshuar, neni 4, përcakton se: *“Prodhuesve dhe shitësve u ndalohet reklama dhe promovimi i produkteve të përcaktuara në nenin 2, pika ç) duke përfshirë këtu paraqitjen speciale, vizuale në ekrane dhe nëpërmjet internetit e mediave sociale, reklamat për ulje çmimi, çmimet stimuluese, shitjet speciale, ulje çmimi me kushte të veçanta apo dhuratat, “kampionë të produkteve të caktuara”, si dhe promovimi i tyre në një qendër shëndetësore apo institucion tjetër të sistemit shtetëror ose privat”.*

Theksojmë se në kuptim të nenit 2, pika ç), të Ligjit nr. 8528, datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjii”, i ndryshuar, me “Produkt i përcaktuar për shitje” kuptohet:

- *Formulë për foshnjat, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël, nga lindja deri në gjashtë muaj.*

-Formulë pasuese, e cila nënkupton qumështin ose një produkt të ngjashëmme qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, që tregtohet si ushqim për foshnjat dhe fëmijët mbi gjashtë muaj.

-Çdo produkt tjetër, i shitur për ushqimin e foshnjave dhe të fëmijëve të vegjël.

Neni 46, pika 2, i Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar parashikon se: “Kodi i transmetimit siguron që ...“reklamat, shitjet e drejtpërdrejta, materialet e shitjeve të drejtpërdrejta, sponsorizimet dhe format e tjera të paraqitjes tregtare, të përdorura në çdo shërbim transmetimi, veçanërisht ato që lidhen me çështje që mund të jenë drejtpërsëdrejti ose jo në interes të të miturve, duhet të ruajnë interesin e tyre, duke pasur kujdes të veçantë për shëndetin e tyre”.

Ky detyrim përcaktohet po ashtu edhe në Kodin e Transmetimit për median audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 221, datë 01.12.2017, në seksionin për reklamat dhe fëmijët.

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave sugjeroi ndërprerjen e transmetimit të kësaj reklame dhe tërhoqi vëmendjen për të mos përsëritur raste të ngjashme, që bien ndesh me kërkesat ligjore.

Palës ankuese i lind e drejta për të drejtën e përgjigjes nëse e kërkon, bazuar në nenin nr. 53 të ligjit nr 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” si dhe Rregullores “Mbi procedurat për trajtimin e ankesave dhe për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes”, miratuar me vendimin nr. 181, datë 11.09.2017.

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave masën tërheqje vëmendje për subjektin në fjalë.

Ankesa e paraqitur nga: **K.SH.**

Subjekti audioviziv:

“Klan” Tv

Programi:

“Opinion”

Data:

25.09.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi K.Sh. pretendon se gjatë emisionit u transmetua një reportazh me produkte të ndaluara nga ligji, konkretisht një transmetim me titullin “Rikthimi i DS legjendare”.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi shkeljen e kërkesave të Ligjit 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke iu referuar ligjit në fjalë, kapitulli “Përkufizime”, *“Komunikim i fshehtë audioviziv me natyrë tregtare” është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërtimeve, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrtojë publikun mbi natyrën e tij”.*

Në reportazhin e transmetuar janë paraqitur me fjalë dhe figurë disa marka cigaresh (“Partizani”, “Porti i kuq”, “Diamant”, “Gent”, “Drini”, “Apollonia” etj) përfshirë edhe markën

“DS”, markë që sipas materialit të transmetuar është rikthyer tashmë në treg. Ndaj, Këshilli i Ankesave çmoi se në këtë rast kemi të bëjmë me një “komunikim me natyrë tregtare” dhe se reportazhi përmban produkte të ndaluara nga ligji.

Në nenin 42, “Komunikimet me natyrë tregtare”, të Ligjit 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, përcaktohet: *“Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara”.*

Pika 4 e të njëjtit nen përcakton se *“Të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për cigaret dhe produktet e tjera të duhanit janë të ndaluara”.*

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave sugjeroi tërheqje vëmendje për të mos përsëritur raste të tilla.





Ankesa të tjera

Ankesa e paraqitur kryesisht nga Këshilli i Ankesave

Subjekti audioviziv:	Programi:	Data:
"BBF" Tv	-----	07.09.2018

Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e një ankese joformale për transmetim të materialeve të papërshtatshme dhe me përmbajtje jo etike të cilat përmbajnë pamje dhe tekste me "drogë, armë e dhunë" të cilat shfaqen në orare kur para ekranit janë edhe të miturit.

Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s vendosi nën monitorim transmetimet e televizionit "BBF" dhe, pas shqyrtimit të materialeve filmike, konstatoi shkeljen e kërkesave të Ligjit 97/2013 "Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit të AMA-s.

Pamje me armë e drogë, si në rastin e videoklipit të këngës së Alkatraz, apo tekste aspak etike si në videoklipin e këngës së Getinjos, që transmetohen në orare të ndjekura edhe nga fëmijët, duhet të shmangen. Sikurse parashikon Ligji 97/2013, në nenin 4, pika 1, germa b), veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton "në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve". Po ashtu, në nenin 33, pika 1, germa d), sanksionohet se "ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik...". Këto kërkesa të ligjit janë theksuar edhe në Kodin e Transmetimi. Në Seksionin 1, pikat

1.4, 1.7, si dhe në Seksionin 5, pika 5.29, thuhet se "OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese... duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë së publikut dhe efekteve të programeve të tyre në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve".

Ndërsa në pikat 5.32, 5.33 po të Kodit, përcaktohet se kur transmetohen programe që mund të dëmtojnë fëmijët duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose viziv, si dhe në pikat 5.34 e 5.45 përcaktohet se OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh shkallën e efektit të shkaktuar nga materiale që dëmtojnë fëmijët, si dhe të shmangen rreziku i varësisë ndaj televizionit dhe imitimit të modeleve.

AMA vlerëson angazhimin e subjektit, sikundër dhe të subjekteve të tjerë të formatit muzikor, për promovimin e kulturës kombëtare dhe të krijimtarisë muzikore në gjuhën shqipe. Por ky proces argëtimi, edukimi dhe informimi duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave rikujtoi për subjektin se AMA ka tërhequr vëmendjen edhe më parë, dhe iu bë e ditur subjektit se është nën monitorim të vazhdueshëm. Në rast përsëritjeje të shkeljes së Ligjit 97/2013 "Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit, AMA do të fillojë procedimin sipas kërkesave të parashikuara ligjore.

Ankesa e paraqitur nga: **E.K.**

Subjekti audioviziv:

“Top Channel”

Programi:

“Hell’s Kitchen”

Data:

30.10.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se programi i ri mbi kuzhinën i transmetuar në “Top Channel” ka shkelje të etikës dhe diskriminim ndaj gruas. Programi që ju përshkruani është një format i njohur ndërkombëtar i krijuar nga kuzhinieri britanik Gordon Ramsey. Përmbajtja e këtij programi të transmetuar nga “Top Channel” është pothuaj i ngjashëm me formatin britanik, i cili ka për subjekt tensionin brenda një kuzhine restoranti.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik të transmetimit të emisionit dhe nuk vërejti shkelje etike apo diskriminuese ndaj grave. Format i spektaklit dikton krijimin e grupeve të konkurrentëve që garojnë me njëri tjetrin e që ndahen në mënyrë rastësore. Ky spektakël me patentë të huaj është shfaqur në shumë vende të botës. Për më tej, Autoriteti i Medias Audiovizive do të ndjekë nga afër këtë program dhe të tjera që u referohen formateve të njohura në botë me qëllim respektimin e normave ligjore dhe etike.

Ankesa e paraqitur nga: **R.D.**

Subjekti audioviziv:

“Digitalb”

Programi:

Data:

30.10.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se është posedues i një aparati “Digitalb”, me abonim vjetor, përfshirë dhe sportet. “Aktualisht, kur në programacion, në kanalin “Supersport 5”, duhet të transmetohej turneu i tenisit, të cilin e konfirmoi edhe komentatorja, në mënyrë të njëanshme, kompania vendosi të transmetojë ndeshjet e futbollit”, thuhej në ankesë i cili shton se e ka ngritur këtë shqetësim pranë kompanisë, dhe është njoftuar se “ky transmetim (turneu i tenisit) ka kaluar në kanalin “Supersport” 7”, i cili është vetëm për aparate satelitorë.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave sugjeroi se pretendimi ka në thelb zbatimin e detyrimeve kontraktore për shërbimet me abonim. Bazuar në Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, duhet paraqitur një ankesë me shkrim ndaj kompanisë me të cilën është lidhur kontratë për shërbimet me abonim.

Pika 1 e nenit 51 e Ligjit 97/2013 përcakton se *“OSHIMA-ja është e detyruar të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 të këtij ligji, mbi cilësinë e shërbimit të ofruar ose përmbushjen e detyrimeve kontraktore për shërbimet me abonim”.*

Ankesa e paraqitur nga: **M..D.**

Subjekti audioviziv:	Programi:	Data:
Të gjitha	Të gjitha	26.03.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Ankesa lidhet me një pretendim të shtetasit M.D sipas të cilit ka dëmtime shëndetësore nga teknologjia e transmetimeve televizive dhe është i detyruar prej 4 vitesh që të marrë medikamente e në këtë rast kërkon ndërhyrjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive për kufizim transmetimesh.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se bazuar në Ligjin 97/ 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 përcakton se, AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 1, ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre.

AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, bazuar në nenin 18 të ligjit të sipërcituar siguron; a) që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve

të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve si dhe, ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias, etj.

AMA nxit: a) promovimin e programeve të shumëllojshme dhe pa pagesë; b) sigurimin e shumëllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të programeve dhe me risi nga OSHMA-të publike e private.

Ndaj, nisur nga sa më sipër, sqarojmë se nuk është pjesë e ligjit 97/ 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kufizimi i orareve audiovizive. Transmetimet audiovizive rregullohen me anë të një programacioni të larmishëm kundrejt zbatimit të parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, sipas nenit 4 të ligjit në fjalë.

Ankesa e paraqitur kryesisht nga Këshilli i Ankesave

Subjekti audioviziv:

Të gjitha

Programi:

Edicionet informative

Data:

22.11.2018**1. Përmbledhje e ankesës**

Kujtesë për zbatimin e ligjit nr.97/2013 për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë mbi transmetimet për personat me nevoja të veçanta shqisore

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave bazuar në:

-nenin 3 të Ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, seksioni “Përkufizime”, pika 10, sipas të cilës: “Komunitet me nevoja të veçanta shqisore” është komuniteti me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit”;

-nenin 32 të Ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, seksioni “Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive”, pika 5, sipas së cilës: “Shërbimet e transmetimeve audiovizive marrin parasysh nevojat e personave me nevoja të veçanta shqisore”;

-nenin 47 të Ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, seksioni “Rregulloret e transmetimit”, pika 2, germa a), sipas së cilës: “Rregulloret e transmetimit... duhet të përcaktojnë për çdo OSHMA sigurimin e shërbimeve të tilla si: a) gjuha e shenjave”;

-nenin 67 të Ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, seksioni “Licenca e shërbimit për programet audiovizive”, pika 1 dhe 2, germa dh), sipas të cilave: “AMA jep licenca shërbimi për programet audiovizive, në bazë të së cilës i licencuari ka të drejtat dhe detyrimet për të ngritur dhe realizuar një shërbim programi audioviziv. Në bazë të licencës, i licencuari ka të drejtë për të ngritur, realizuar dhe vënë në funksion pajisje transmetuese, me qëllim transmetimin e shërbimit të programit audioviziv. AMA siguron që shërbimi i programit audioviziv...të përfshijë, në mënyrë të arsyeshme përdorimin e gjuhës së shenjave në emisionet e lajmeve për njerëzit që nuk dëgjojnë”;

Rikujtoi zbatimin e Ligjit nr. 97/2013 mbi transmetimet për personat me nevoja të veçanta shqisore dhe marrjen e masave nga ana Juaj për konkretizimin e transmetimeve me bazë gjuhën e shenjave.

5

*Ankesa
të rrëzuara*

Ankesa e paraqitur nga: **N.K.**

Subjekti audioviziv:

Jashtë ligjit

Programi:

-

Data:

16.11.2018

1. Përmbledhje e ankesës

Shtetasi N.K. pretendonte se ndaj personit të tij ishte shpifur nga një faqe interneti.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Ankesa është jashtë kuadrit ligjor mbi të cilin bazohet veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Si e tillë, ankesa ishte jashtë objektivit të punës së Autoritetit, e për rrjedhojë, edhe jashtë objektivit të punës së Këshillit të Ankesave pranë AMA-s.

